




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-32269/23 datë:15.12.2023



Npi – 01/466 datë: 27.12.2023

Duke u bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), neni 17 shkronja (f), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Nenin 47 të Ligjit për Ujrat e Kosovës Nr. 04/L-147 “Programi për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave”; Udhëzimit Administrativ 19/2015, për Veprimet e Dëmshme të Ujërave; Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit. Planin Zhvillimor Komunal i miratuar më 31.10.2009 si dhe Planin Zhvillimor Urban i miratuar më 31.10.2009; Udhëzimit Administrativ të MAPL-së Nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna; Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e mbajtur më: 27.12.2023 mori këtë:

V E N D I M

**PËR DISKUTIM PUBLIK TË
DRAFT-PROGRAMIT STRATEGJIK PËR UJËRAT NË KOMUNËN E SHTIMES**

I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -IX-të për vitin 2023, të mbajtur më: 27.12.2023, me shumicën e votave miratoi vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Programin Strategjik për Ujërat në Komunën e Shtimes për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Shërbime Publike, në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit dhe Zyrën për Informim.

II

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi